



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Procesverbal - Tipi i kontrates - PUNE

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashk dokumentat e tenderit)

OBJEKTI I PROÇEDURËS – “Rikonstruksion i rruges Lagjia e Re e qytetit Fushe-Arrez,
Bashkia Fushe-Arrez”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 44113600-1 Asfalt, 14213000-7 Çakell dhe rërë bitum, 44114100-3 Beton me perzierje te gatshem, 45112000-5 Punime gerrmimi

VLERA E FONDIT LIMIT – 12 412 492 (dymbëdhjet milion e katerqind e dymbëdhjete mije e katerqind e nentëdhjet e dy) **Leke pa TVSH**

Në bazë të nenit 77, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Fushë-Arrëz**, ka hartuar procesverbalin për argumenimin dhe miratimin e specifikimeve tenike dhe kriterëve për kualifikimin për procedurën e sipercituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet te paraqese bilancet e tyre vjetore, per nje periudhe maksimumi tre vitet e fundit financiare(2022,2023,2024), qe tregojne raportet, ndermjet aktivitet dhe pasivitet. Kërkesa konsiderohet e permbushur nese ne dy bilancet e njepasnjeshem te kerkuar, nuk ka raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivitet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Permbushja e ketij kriter i shërbenë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.2 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit .

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1. Ky kriter është vendosur me qëllim sigurimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, si dhe AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2024 ,sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoritetet përkatëse sipas adresave të regjistruar në QKB.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP i ndryshuar, si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c. Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632,date 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore .

2.2.4 Për të provuar përvojën e mëparshme, operatorët ekonomik duhet të paraqesin

a) pune të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b) pune të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohej vërtetimi të leshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shenohen vlerat, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, kërkohej si dëshmi, vërtetimi, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shenohen vlerat, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që përvon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 39, pikë 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 50% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Rrull cat	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Matrapik dore	copë	1	Në pronësi ose me qera

3	Minifadrome bobcat	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Kamioncine veteshkarkuese 2 ton e lart	copë	1	
5	Kamion veteshkarkues 20ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Kamion veteshkarkues 15 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Gjenerator trefazor	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Eskavator me goma+çekiç pneumatik	copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Eskavator me zingjir	copë	1	Në pronësi ose me qera
10	Autoboot uji 10 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Autobetoniere	copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Betoniere dore	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Vibrator betoni (elektrin/djegje te brendeshme)	copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Rrul 10 ton e lart	copë	1	Në pronësi ose me qera
15	Asfaltoshtruese	copë	1	Në pronësi ose me qera
16	Greider	copë	1	Në pronësi ose me qera

a. Për mjetet në pronësi duhet:

- akti i pronësisë.
- leje qarkullimi.
- çertifikate e kontrollit teknik.
- siguracion mjeti.
- çertifikatë për transport mallrash brenda vendit.

b. Për mjetet e deklaruar me qera duhet: të paraqitet: a)

- kontrata e qerasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës.
- akti i pronësisë.
- leje qarkullimi.
- çertifikaten e kontrollit teknik.
- siguracion mjeti.
- çertifikatë për transport mallrash brenda vendit.

Dokumentacionet duhet te jene te vlefshme

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku të deklarojë se makinerit/mjetet/pajisjet e deklaruar në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jenë në dispozicion gjatë zbatimit të kontratës dhe nuk janë të angazhuara në kontratë tjetra.

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nepermjet ketyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 216 datë 13.04.2023 “Mbi krijimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të cmimit të ndërtimit”. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Rrullcat përdoret për ngjeshjen e shtresave dhe nenshtresave asfaltike në pjesë të rrugës ku kemi ndryshim të gjerësisë. Matrapikët përdoret për thyerje të betoneve aty ku nuk përdoret çekici pneumatik. Minieskavatori përdoret për punimet e vogla germimi dhe nivelimi. Kamioncina përdoret për transportin e materialeve në sasi të vogla brenda sheshit të ndërtimit. Kamionet 15 dhe 20 tonsh përdoren për furnizimin me lende të pare ndërtimore si zhavorr, hekur, tumbin, cemento. Gjeneratori përdoret për furnizimin e energjisë elektrike të kantierit. Eskavatori me gomë përdoret për germime dhe nivelime të trases së rrugës si dhe hapje të kanaleve anësore. Eskavator me zingjir shërben për germime në terrene me fortësi mesatare e të lartë. Autoboti i ujit përdoret për furnizimin me ujë për betonin dhe lagjen e shtresave sipas rastit. Autobetoniere shërben për përgatitjen e betoneve. Vibratori i betonit shërben për vibrimin e betoneve të gjithë llojeve. Rrulli 10 ton i lartë përdoret për ngjeshjen e shtresave dhe nenshtresave asfaltike në pjesën kryesore të rrugës. Asfaltoshtuese përdoret për hedhjen, nivelimin e tabelës së asfaltit. Grederi shërben për shpërndarje dhe nivelimin e nenshtresave të asfaltit.

2.3.2 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve si mëposhte :

- a) Inxhinier Topograf 1(nje).
- b) Inxhinier Ndërtimi 1(nje)

Të gjithë duhet të jenë të shoqëruar me licencë, diplomë dhe kontratë pune.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, mjedisi, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Kërkesa specifike për inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë preventivit të punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë

Duke marrë në konsideratë projektin e zbatimit si dhe preventivin e punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë punonjes të kualifikuar sipas profesioneve:

- a) Murator 2.
- b) Armator 3.
- c) Manovrator 2.
- d) Drejtues mjetesh 2.

Te gjithë duhet të jenë të shoqëruar me deshmë kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT dhe kontrate pune.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë fuqi minimale puntore të thjeshtë 6 persona, të vertetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave dhe listat e pagesat përkatëse të konfirmuara nga autoritetet përgjegjëse.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë

qëndrueshmëri të stafit pa shkëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

2.3.5 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- NP-1/A “Punime gjermimi në tokë”
- NP-4/A “Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale”
- NP-7/A “Ujsjeles kanalizime, vepra kullimi e vaditje”
- NS-1/A “Punimet e prishjes se ndertimeve”
- NS-18/A “Punime topogjeodezike”

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Argumentim: Kërkesat për certifikatë mesipërme janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e

Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015)

Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001-2015.

Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 45001-2018

Argumentim: Kërkesat për certifikatë mesipërme janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Njesia e Prokurimit